

LIGJ
Nr. 60/2022

PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT TË GJUE TISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë, me qëllim përmirësimin e gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

Neni 2
Objekti dhe fusha e veprimit

Ky ligj përcakton rregullat që do të zbatohen gjatë ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Pezullimi i përdorimit të zonave të gjuetisë dhe pezullimi i gjuetisë në zonat e mbarështimit të faunës së egër

1. Përdorimi i zonave të gjuetisë, të dhëna për këtë qëllim nëpërmjet ofertës publike sipas legjislacionit në fuqi për gjuetinë, pezullohet.
2. Kontratat për mbarështimin e faunës së egër janë të vlefshme, por edhe në këto zona ku mbarështohet fauna e egër nuk mund të ushtrohet gjuetia deri në afatin e zbatimit të këtij ligji.

Neni 4
Përfshirje nga fusha e veprimit

1. Përfshihen nga fusha e zbatimit të nenit 2 të këtij ligji:
 - a) gjuetia në rastet e konstatimit të mbipopullimit të një lloji të faunës së egër në zonat e lejuara për gjueti dhe në rezervatet e mbarështimit, si dhe në rastet e konstatimit të dëmtimit të kulturave bujqësore, blegtorisë dhe ndaj jetës njerëzore në zonat rurale sipas legjislacionit në fuqi për gjuetinë;
 - b) gjuetia për qëllime kërkimore-shkencore.
2. Rastet përjashtimore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 5
Afati i zbatimit

Afati i zbatimit të këtij ligji është tre vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 6 **Organet e kontrollit**

1. Organet që kontrollojnë zbatimin e rregullave për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- a) ministria përgjegjëse për mjedisin nëpërmjet strukturave të saj përgjegjëse kontrolluese/inspektuese brenda fushës së saj të përgjegjësisë;
- b) Ministria e Brendshme nëpërmjet Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Policisë së Shtetit;
- c) strukturat përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki.

2. Veprimtaria kontrolluese, sipas këtij neni, ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Të drejtën e vendosjes së gjobës e kanë strukturat që janë përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Shqyrtimi e marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj tij bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, si dhe me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 7 **Sanksionet**

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

- a) kur shkelja kryhet e organizuar nga operatorët e tureve të gjuetisë, shoqatat e gjuetarëve ose federatat e gjuetarëve, subjekti që e organizon dënohet me gjobë në masën 800 000 (tetëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë;
- b) kur shkelja kryhet nga një person ose personi është pjesëtar i subjekteve organizuese sipas shkronjës “a” të kësaj pike, personi dënohet me gjobë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Në rastet e përsëritjes së shkeljes nga subjektet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, përveç dënimit me gjobë, vendoset si dënim plotësues edhe heqja e lejes së gjuetisë, si dhe konfiskimi i armës së gjahut.

Neni 8 **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore rast pas rasti në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 9 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 21.7.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 13844, datë 5.8.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**